



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 72

Datë: 27.12. 2017, ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.71/2017

2. Certifikimi i rezultateve përfundimtare të rivotimit për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave në Istog;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zëvendësimin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Rahovec;
5. Vlerësimi vjetor i punës së Drejtorit të ZRPP-së dhe Zëdhënësit të KQZ-së;

6. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.71/2017

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 72 të KQZ-së. Rendin e ditës e keni para jush. A ka dikush vërejtje? Nëse jo kush është për këtë rend dite.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës

Valdete Daka: Pika e parë, është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar. A ka dikush vërejtje në këtë procesverbal? Nëse jo kush është për miratimin e këtij procesverbali?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin nga mbledhja nr.71/2017

2. Certifikimi i rezultateve përfundimtare të rivotimit për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave në Istog

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër certifikimi i rezultateve të rivotimit në komunën e Istogut. Paraprakisht KQZ-ja ka kërkuar nga gjykata supreme dhe PZAP-i a ka ndonjë ankese e cila ende është në shqyrtim pranë këtyre institucioneve. Pasi që kemi marr shkresat me të cilat vërtetohet as në PZAP as në gjykatë supreme nuk ka ankesë e cila ka të bëjë me rezultatet përfundimtare për kryetar komune të Istogut. Pran jush janë sjell rezultatet përfundimtare, të cilat janë si në vijim. Statistikat janë, numri i votuesve të regjistruar janë 49235, numri i votuesve të cilët kanë votuar në secilin vendvotim 19869, numri i votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimeve 505. Pjesëmarrja në votime 41.38%, numri i votuesve që kanë votuar 20502 votues, numri i fletëvotimeve të pa vlefshme 139, numri i fletëvotimeve të zbrastë 11, numri i fletëvotimeve të përdorura 20502, numri i fletëvotimeve të pa përdorura 24607, numri i fletëvotimeve të dëmtuara 11. Kjo është sa i përket statistikave, ndërsa sa i përket rezultateve, Haki Rugova nga subjekti LDK ka gjithsej 10033 apo 50.03% dhe kandidati Gani Dreshaj nga subjekti politik AAK 10019 vota apo 49.97%. Kush është për certifikimin e këtij rezultati? Faleminderit, kush është kundër? Faleminderit. Me 8 vota për 1 kundër, konstatohet se është certifikuar rezultati dhe me këtë, janë përmbyll zgjedhjet lokale. Unë ju uroj sukses të gjithë

kryetarëve që janë zgjedhur dhe asamblastëve të kuvendeve komunale, duke ju uruar sukses dhe punë të mbarë.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zëvendësimin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zëvendësimin e Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në fakt rekomandohet. I kemi Presidenti i Republikës së Kosovës, kemi marr dy kërkesa me dërgimin e emrit sipas radhës i cili do të zëvendësoj Muzahir Haskukaj nga subjekti politik VV dhe sipas radhës është Shemsi Syla. Kush është që të rekomandohet zëvendësimi i tij? Faleminderit. Kërkesa tjetër ka të bëjë me z. Qendron Kastrati deputet i subjektit VV i cili është zgjedhur kryetar i komunë së Kamenicë, dhe pas tij është Sali Zyba. Kush është për miratimin e këtij emri? Faleminderit. Deputetëve të ri ju uroj po ashtu punë të mbarë. Vazhdojmë me pikën tjetër, shqyrtimi dhe miratimi i kërkesën për antarëve të komunave Prishtinë, Rahovec.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Rahovec;

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare, kërkesë për zëvendësimin e antarëve nga kuvendi komunal i Rahovecit që është 1 dhe nga Prishtina janë 3. Dokumentacioni nga zyra ligjore është i plotësuar dhe janë plotësuar gjitha kërkesat ligjore që të bëhen këto zëvendësime.

Valdete Daka: Faleminderit Sami. Atëherë kush është që nga komuna e Rahovecit të emërohet antar i kuvendit komunal Afrim Berisha i cili do të zëvendësoj Fatmir Iskën nga subjekti politik AAK. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për këtë zëvendësim

Valdete Daka: Në Prishtinë, kemi Qendrim Sahiti i cili do ta zëvendësoj antarin Arben Vitija nga subjekti politik VV. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për këtë zëvendësim

Valdete Daka: Në komunën e Prishtinës po ashtu, Milot Podvorica do ta zëvendësoj antarin e kuvendit komunal Genca Bashota nga subjekti politik VV. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për këtë zëvendësim

Valdete Dka: Persëri në komunën e Prishtinës, Vala Peshku emërohet anëtare e kuvendit komunal e cila do ta zëvendësoj Nora Kelmendi nga subjekti politik VV. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për këtë zëvendësim

Adnan Rustemi: Tek ky rasti që zëvendësuam Nora Kelemendi me Vala Peshku, le ta verifikoj Sekretariati se, mos po bëhet ndonjë gabim, a është sigurt Vala, se mos është Mimoza Sylejmani?

5. Vlerësimi vjetor i punës së Drejtorit të ZRPP-së dhe Zëdhënësit të KQZ-së;

Valdete Daka: Pika tjetër ka të bëjë me vlerësimin e Drejtorit të Zyrës së Partive Politike, dhe të Zëdhënësit të KQZ-së. Sot, është afati i fundit. I kisha lutë mediat dhe të gjithë ata që nuk janë kompetentë, ta lirojnë sallën...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
